# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-475679**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Top Channel/ Dorëhiqet Vuçiç. Lë postin e Presidentit, synon të bëhet Kryeministër - Top Channel |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/video/top-channel-dorehiqet-vucic-le-postin-e-presidentit-synon-te-behet-kryeminister/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 09:33:33 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| KOHA E PORTALIT | nuk jepet<br>*Ky portal nuk e deklaron datën dhe nuk e shkruan as të dukshme. Mbetet vetëm ora jonë e kapjes.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7512044d4d5078d34343c5d67daad83d496451dba8c9d4bb86ad32e953885948` |
| TEKSTI | `27a01665f4372a4abc432fbad1d694fd46fa2cace08c2b280d334ed1564509fe` |
| PAMJA | `11f57e5991ad6e64b38f54f350cc02833857fc429b0b24efd75d4b4d535e92b5` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `86e453490892cdacd4b51d6791bce0ad41b25a2e7a233e7b5d0ede6c3421ed1e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `abea285c66b625fda61d55a4ce47e92e047f4e5aa34cb0aedb7a5ee71b2cb2e0` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/86e453490892cdacd4b51d6791bce0ad41b25a2e7a233e7b5d0ede6c3421ed1e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

## VIDEO

### Top Channel/ Dorëhiqet Vuçiç. Lë postin e Presidentit, synon të bëhet Kryeministër

28/09/2026 11:28

Në një lëvizje të bujshme Aleksandar Vuçiç ka dhënë dorëheqjen e paralajmëruar këtë të diel të 27 shtatorit nga posti i Presidentit të Serbisë. Pas më shumë se nëntë vitesh në krye të shtetit, Vuçiç shfrytëzoi fjalimin e tij të lamtumirës nga Presidenca për të shpallur një "kapitull të ri" politik, vetëm një muaj përpara zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 25 tetorit. Largimi i Vuçiçit nga presidenca shtatë muaj përpara përfundimit zyrtar të mandatit të tij të dytë nuk shënon një tërheqje nga politika, por një rokadë të llogaritur për pushtet. Kushtetuta e Serbisë ia ndalonte atij kandidimin për një mandat të tretë presidencial. Për këtë arsye, ai ka vendosur të udhëheqë listën e Partisë Progresive Serbe si "qytetar i thjeshtë" dhe synon të emërohet Kryeministër i ri i vendit nëse partia e tij arrin të formojë qeverinë. Detyrën e Presidentit të përkohshëm do ta ushtrojë kryetarja e Parlamentit, Ana Brnabiç, ndërsa zgjedhjet e reja presidenciale duhet të mbahen brenda 90 ditëve. "Në fjalimin e tij të fundit, Vuçiç u ndal gjatë te çështjet gjeopolitike, duke lënë disa mesazhe të qarta për pasuesit e tij. Ai porositi me tone të ashpra se Beogradi nuk duhet të heqë dorë kurrë nga mbështetja për serbët në Kosovë, duke refuzuar idenë se braktisja e kësaj kauze do t'i sillte Serbisë një të ardhme më të mirë. Vuçiç kërkoi që vendi të vazhdojë rrugën e integrimit evropian, por pa sakrifikuar lidhjet e ngushta me ato që i quajti "miqtë tradicionalë në Lindje" (duke iu referuar Rusisë dhe Kinës).Ai u mburr për rënien e borxhit publik nga 77% në 43% të PBB-së, si dhe për hapjen e më shumë se 300 fabrikave gjatë dekadës së tij në pushtet. Tashmë, vëmendja zhvendoset e gjitha te kutitë e votimit të 25 tetorit, ku partia e Vuçiçit do të përballet me lëvizjen anti-korrupsion të studentëve "Lista e Studentëve" dhe opozitën pro-perëndimore.




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.